



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

## Raport për tremujorin e parë 2023

Oda e Mjekëve të Kosovës



Prill 2023

Prishtinë

## **Përmbajtja:**

Raport për tremujorin e parë 2023.....	1
1. Infrastruktura Juridike .....	2
2. Këshilli Drejtues.....	3
3. Anëtarësimi .....	4
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale.....	5
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional .....	6
6. Licencimet .....	6
7. Këshilli Mbikëqyrës .....	7
8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së.....	7
9. Komisioni për Edukim Specialistik.....	7
10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke .....	8
11. Raporti financiar.....	8
11.1 Raporti financiar për periudhën deri me 31 Mars 2023.....	8
11.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional .....	9
11.3 Prokurimi .....	9
12 Aktivitete të tjera.....	10
12.1 Botimi i Revistës Mjeku .....	10
12.2 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim.....	10
12.3 Ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së.....	12
12.4 Marrëdhëniet ndërkombëtare .....	12
12.5 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike.....	13
13 Plani i veprimit për 2023 .....	14

### **1. Infrastruktura Juridike**

Gjatë këtij tremujori është mbajtur një (1) mbledhje e kuvendit të OMK-së.

Me datë 15 shkurt 20223 u mbajt mbledhja e pestë (5) e legjislaturës së tretë e Kuvendit të OMK-së.

Në këtë mbledhje u bë aprovimi i raportit të punës së Odës së Mjekëve të Kosovës për vitin 2022. Poashtu u aprovua Draft Projekt Buxheti i OMK-së, për vitin 2023 si

dhe vendimet për caktimin e kuotës së anëtarësisë në OMK dhe për caktimin e taksave administrative në OMK.

Gjithashtu në këtë mbledhje u bë plotësim-ndryshimi i Rregullorës së Komisionit për Edukim të Vazhdueshëm Profesional si dhe u bë dhënia e betimit nga një përfaqësues i ri i njësisë zgjedhore të Klinikës së Gjinekologjisë;

## **2. Këshilli Drejtues**

Në periudhën kohore janar – mars 2023, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur tri (3) takime si dhe në 1 rast kanë votuar elektronikisht përmes e-mailit ku janë shqyrtuar lëndët si më poshtë:

<b>Organi</b>	<b>Numri i lëndëve të pranuar për periudhën janar– mars</b>	<b>Vendimet/ Përgjigjet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën janar– mars</b>	<b>Vendimet në procedurë</b>	<b>Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën janar– mars</b>	<b>Vendime/Pergjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake</b>
<b>Këshilli Drejtues i Odës</b>	13	17	5	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendim për aprovim të raportit të OMK-së, për vitin 2022;</li> <li>- Vendim për Draft Projekt Buxhetin final të OMK-së, për vitin 2023;</li> <li>- Vendim për aprovim të draft Rregullorës së Komisionit për Edukim të Vazhdueshëm Profesional;</li> <li>- Vendim për Publikim të Konkursit Publik për financimin e 10 punimeve shkencore;</li> <li>- Vendim për themelim të Komisionit Ad-Hoc, për përzgjedhjen e punimeve shkencore për vitin 2022;</li> <li>- Vendim për pezullim të përkohshëm për taksën administrative</li> </ul>	0

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën janar– mars	Vendimet/ Përgjigjet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën janar– mars	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën janar– mars	Vendime/Pergjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
				Neni.4parag.1.nenparagrafi 1.1 i Vendimit KO 12-2022;	

### 3. Anëtarësimi

Gjatë periudhës kohore janar – mars 2023, në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 164 mjekë, nga të cilët janë 5 mjekë të punësuar në sektorin publik, 13 mjekë të punësuar në sektorin privat, 144 mjekë të papunë dhe 2 mjekë në pension.




Tabela 1.1: Anëtarësimet për periudhën kohore janar - mars 2023




Tabela 1.2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 31 mars 2023

Gjatë kësaj periudhe janë ndarë nga jeta 2 mjekë si dhe janë rianëtarësuar 16 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 31 mars është 5221 mjekë.

#### **4. Mbikëqyrja etiko-profesionale**


Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM 1	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM 1	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM 1	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM 1	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
<b>Prokurori i Odës</b>	15	5	N/A	N/A	2	12
<b>Këshilli Etik</b>	12	3	Rekomandime kolegjale 2 Qortim Publik 1	Rekomandime kolegjale 2 Qortim publik 1	3	12

<b>Gjyqi i Nderit</b>	2	2	///	///	0	0
<b>Certifikatat e të kaluarës etike</b>	905	///	///	///	///	///


### **5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional**

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë periudhës janar - mars 2023 ka akredituar 72 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, një shoqatë ka bërë kërkesë për përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve dhe kërkesa është aprovuar nga Komisioni. Ndërsa 7 prej këtyre akreditimeve janë me taksë administrative.



### **6. Licencimet**

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë periudhës janar - mars 2023, ka lëshuar 419 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



## **7. Këshilli Mbikëqyrës**

Gjatë periudhës janar-mars 2023 Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur pesë (5) takime ku i kanë shqyrtuar Vendimet e Këshillit Drejtues, Këshillit Etik, Prokurorit, Gjyqit të Nderit të OMK-së dhe të organeve të tjera të OMK-së.

## **8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së**

Në periudhën kohore Janar-Mars 2023, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar gjithsej 22 kërkesa për leje-hulutmime dhe janë marr 18 vendime ku prej tyre 14 kanë qenë vendime për aktejtjime, 3 vendime për kthim raporti, 1 vendim shfuqizues.

## **9. Komisioni për Edukim Specialistik**

Në periudhën kohore janar - mars 2023, Komisioni për Edukim Specialistik ka mbajtur një (1) takim. Përgjatë këtij takimi komisioni ka diskutuar për përfshirjen e propozimeve të OMK-së (KES) në Udhëzimin Administrativ për Shkollim Specialistik 01/2023.

**10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke**

Në periudhën kohore janar-mars 2023, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së ka pranuar gjashtë (6) kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka nxjerrë katër (4) vendime për aprovimin e kërkesave të parashtruara nga palët dhe dy (2) vendime për refuzim të kërkesave. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke poashtu ka shfuqizuar edhe katër (4) vendime të nxjerra në periudhën tetor-dhjetor 2022, të cilat i ka nxjerrë sipas detyrës zyrtare (ex-officio) për mjetet e ndara në emër të shpenzimeve të varrimit nga Fondi i Solidaritetit i OMK-së për familjet e ngushta të mjekëve anëtar të OMK-së që kanë ndrruar jetë gjatë periudhës kohore qershor-korrik 2022 (Shënim: Mjetet e tilla ndahen konform dispozitave ligjore të Rregullores së Komisionit për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke).

**11. Raporti financiar****11.1 Raporti financiar për periudhën deri me 31 Mars 2023**

<b>1.0 Të hyrat:</b>		
1.1 Paraja në bankë me 31.12.2022	€ 810,867.00	
<b>Total Paraja në bankë me 31.12.2022</b>		<b>€810,867</b>
<b>1.2 Të hyrat</b>	<b>Realizimi: TM1</b>	<b>TOTAL</b>
1.2.1 Të hyrat nga anëtarësia:		
1.2.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 271,885	€ 271,885
1.2.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 3,380	€ 3,380
1.2.2 Licencimi	€ 20,250	€ 20,250
1.2.3 Të hyrat e tjera*	€ 11,229	€ 11,229
<b>Të hyrat deri me 31.03.2023</b>	<b>€ 306,744</b>	<b>€ 306,744</b>
<b>Paraja në bankë me 31.12.2022</b>		<b>€ 810,867</b>
<b>TOTAL TË HYRAT</b>		<b>€ 1,117,611</b>



<b>2.0 SHPENZIMET</b>	<b>Shpenzimet: TM1</b>	<b>TOTAL</b>
2.1 Paga, medetje dhe kontributet pensionale	€ 66,904	€ 66,904
2.2 Material shpenzues	€ 2,220	€ 2,220
2.3 Reprerentacioni	€ 1,380	€ 1,380
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 9,151	€ 9,151
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 18,996	€ 18,996
2.6 Shpenzimet e aseteve	€ 2,895	€ 2,895
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 2,000	€ 2,000
2.9 Llogarit e pagueshme me 31.12.2022	€ 9,510	€ 9,510
2.10 Llogarit e pagueshme me 31.03.2023	€ (10,391)	€ (10,391)
<b>TOTAL SHPENZIMET 31.03.2023</b>	<b>€ 102,664</b>	<b>€ 102,664</b>
<b>Neto të hyrat për TM1 2023</b>	<b>€ 204,080</b>	<b>€ 204,080</b>
<b>TOTAL BILANCI 31.03.2023</b>		<b>€ 1,014,947</b>

1.2.3\*Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Riregjistrim në regjistrin OMK, Faksimili, Faksimili i dytë, Certifikata për të kaluarën etike profesionale, Taksa për paraqitjen e provimit, Kongreset, simpoziumet, seminarët, Lejimi për hulumtime për persona juridik, Të ardhurat nga interesi BKT, Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera.

2.5 \*Faksimili, Shpenzimet për botimin e revistës, Organizimi i mbledhjeve të kuvendit, Shpenzimet e ID kartelave të Odë, Shpenzime të përkthimeve/lektorimit, Medetje për udhëtime zyrtare, Trajnime për stafin, Mirembajtja e softverit për financa, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Shpenzimet e tjera operative.

### **11.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional**

Oda e Mjekëve të Kosovës gjatë periudhës janar - mars 2023 ka akorduar përkrahje financiare për,

- Shoqatën e Nefrologëve të Kosovës me vlerë prej 2,500.00€

### **11.3 Prokurimi**

Gjatë periudhës kohore janar - mars 2023 u zhvillua një procedurë e hapur e prokurimit dhe një procedurë e prokurimit me vlera të vogla.

Në muajin janar u zhvillua një (1) procedurë e hapur e prokurimit për furnizim të OMK-së me pajisje të teknologjisë informative. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata me operatorin ekonomik.

Në periudhën shkurt-mars u zhvillua me sukses procedura e prokurimit me vlera të vogla për përzgjedhjen e OE që do të ofroj shërbime të transportit (Taksi) për OMK-në. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe brenda afatit u lidh kontrata me operatorin ekonomik.

## **12 Aktivitete të tjera**

### **12.1 Botimi i Revistës Mjeku**

Vëllimi 3, Numri 1, i Revistës Mjeku, me temën bosht “Kockat” u publikua gjatë muajit mars 2023.

Ky numër ka në tërësi 35 artikuj, të përmbledhur në 111 faqe.

Artikujt trajtojnë kryesisht temat e fushës së Ortopedisë dhe disa nga temat e shtjelluara në këtë numër janë: Zhvillimi i Ortopedisë Kosovare, Intervistë e realizuar me Z. Lulzim Gecin, drejtor i shërbimit klinik të Ortoprotetikës, QKUK, Protezat e gjurit, Qelizat staminale të osteoartritit, konsolidimi i frakturave kockore, traumat e sistemit osteomuskular e shumë artikuj të tjerë rreth kësaj lëmie. Në këtë numër gjithashtu kemi publikuar edhe kalendarin e programeve të akredituara në OMK, për vitin 2023.

Revista është e publikuar edhe online në faqen e Odës së Mjekëve të Kosovës (REVISTA MJEKU) në mënyrë që të arrijë audiencë më të gjerë.

Në muajin Qershor pritet të publikohet numri i dytë i vëllimit të tretë.

### **12.2 Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim**

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projekti i Luxembourg Development KSV/017, në vitin 2022 kanë nënshkruar marrëveshje për delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të stafit mjekësor të Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Marrëveshja ka të bëjë me zbatimin e aktiviteteve të programit për trajnimin dhe zhvillimin profesional të mjekëve të spitaleve përkatëse. Program i cili është hartuar mbi planin e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën 2022-2026 dhe përmes këtyre trajnimeve mjekët e këtyre spitaleve do të kenë mundësi të ngrisin shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në aspektin profesional.

Në këtë drejtim Oda e Mjekëve në bashkpunim me Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit, kanë identifikuar nevojat për trajnime dhe si rezultat ka filluar procesi i

rekrutimit të trajnerave të kualifikuar apo insitucioneve për të implementuar trajnimet e nevojshme.

Në muajin mars 2023, u organizua trajnimi nga lëmia e neonatologjisë me temë “Reanimimi neonatal/Oksigjenoterapia te të porsalindurit” dhe “Vendosja e kateterit qëndror(umbilikal) apo dhe vija të thella dhe transfuzioni te të porsalindurit”. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin 32 Mjekë, mami dhe infermier pediatrik të Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit.

Trajnimi u organizua nën drejtimin e Prof.dr. Boris Filipović-Grcic, MD, PhD, nga Departamenti i Pediatriisë, Qendra Klinike Spitalore në Zagreb dhe prim. Dr. Darjan Kardum, MD, PhD, nga Departamenti i Pediatriisë, Qendra Klinike Spitalore në Osijek. Që të dy mjekët janë Instruktorë ndërkombëtarë të reanimimit të të porsalindurve nga Këshilli Evropian i Reanimimit.

Pas përfundimit të pjesës teorike dhe praktike të trajnimit profesional, trajnerët kanë përgatitur edhe 6 dokumenta manual për procedurat standarde të operimit (ang SOP).

Gjithashtu në kuadër të marrëveshjes është planifikuar edhe trajnimi për ultratingull osteomuskular. Pas kalimit të të gjitha procedurave të rekrutimit të trajnerëve dhe përzgjedhjes së pjesëmarrësve të trajnimit, në muajin maj është planifikuar të organizohet trajnimi. Trajnimi pritet t'u ofrojnë mjekëve aftësi për të ofruar shërbime të specializuara për pacientët dhe t'u mundësojë atyre që të njihen dhe të jenë kompetent në kuptimin, funksionimin dhe aplikimin e pajisjeve ekzistuese në punën e tyre të përditshme në diagnostifikimin klinik brenda departamenteve të tyre spitalore.

Projekti i Luxembourg Development KSV/017, në vitin 2022 fillimisht ka alokuar vlerën prej 120,000.00€ kurse në fund të vitit 2022 pas suksesit të treguar nga OMK për realizimin e trajnimeve, marrëveshjes bazë i është shtuar amandamenti 1, ku janë alokuar mjete shtesë për implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve të odës, si dhe mbështetjen për organizimin të trajnimeve profesionale-profilizimeve për një numër të përzgjedhur të mjekëve nga spitalet e përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Si pjesë e amandamentit 1 të marrëveshjes (DAFI KSV/017•21 2749), përfaqësues nga Oda e Mjekëve të Kosovës në bashkëpunim me përfaqësues nga projekti i Qeverisë së Luksemburgut për shëndetësi KSV/017 dhe përfaqësues nga Spitali i Përgjithshëm i Gjilani dhe Prizrenit kanë vizituar Spitalin e Përgjithshëm Izola, Murska Sobota dhe Celje në Slloveni. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë për të diskutuar dhe finalizuar marrëveshjen për realizimin e trajnimeve profesionale për mjekët e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit. Mjekët e Spitalit të Gjilanit dhe Prizrenit do të përfitojnë nga marrëveshja e trajnimeve profesionale që do zgjasin sipas kërkesave

dhe nevojave, e që kryesisht do të jenë të fokusuara nga lëmia e Kardiologjisë intervente, Laparaskopisë, Mjekësisë Emergjente dhe Menaxhimit shëndetësor dhe cilësisë të Spitaleve.

Me datë 17 mars 2023, OMK ka nënshkruar marrëveshje partneriteti me Spitalin e Përgjithshëm Izola, Murska Sobota dhe Celje nga Sllovenia për ngritjen e kapaciteteve klinike të stafit mjekësor të Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit. Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të shërbejë si platformë për shkëmbimin e përvojave më të mira dhe gjithashtu do t'u mundësojë mjekëve të Spitaleve të Prizrenit të Gjilanit dhe Spitaleve Sllovene të përfitojnë dhe zhvillohen profesionalisht përmes shkëmbimit të përvojave.

### **12.3 Ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së**

Në kuadër të marrëveshje për delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve, është e përfshirë edhe ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së. Në fazën e parë janë organizuar trajnime të ndryshme gjithëpërfshirëse, si dhe ato specifike si kursi për Procedurat e përgjithshme administrative.

Gjithashtu nga ekspertë ndërkombëtar për zhvillimin organizativ, është bërë, vlerësimi organizativ dhe i nevojave të odës. Rezultati i këtij vlerësimi ishte shumë pozitiv dhe është paraparë një strategji afatgjatë për ngritjen e kapaciteteve të stafit të odës. Ekspertë ndërkombëtar së bashku me menaxhmentin e OMK-së janë në proces të identifikimit të nevojave për trajnime shtesë që do të ndihmonin në ngritjen e kapaciteteve dhe ofrimit të cilësisë së shërbimit në odë.

### **12.4 Marrëdhëniet ndërkombëtare**

#### **Mbledhja e Komitetit të Përhershëm Evropian të Mjekëve (CPME).**

Komiteti i Përhershëm Evropian i Mjekëve (CPME) në muajin mars mbajti punimet e rregullta 6 mujore. Takimi i radhës është mbajtur në Dubrovnik, ku përfaqësuesi i Odës së Mjekëve të Kosovës morri pjesë në punimet e takimit të radhës së Komitetit të Përhershëm Evropian të Mjekëve (CPME).

Nikoqiri i këtij takimi ishte Oda e Mjekëve të Kroacisë. Tema diskutimi gjatë mbledhjes ishin:

- Shëndetësia dixhitale
- Praktika profesionale dhe sistemet shëndetësore
- Parimet, pacientët dhe etika

- Praktika profesionale dhe sistemi shëndetësor
- Shëndeti publik dhe parandalimi i sëmundjeve

Temë e diskutimi në takim ka qenë edhe dhuna ndaj mjekëve dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor në shtetet evropiane. Sipas raportimeve nga shoqatat mjekësore në Evropë është rritja e dhunës verbale dhe fizike. CPME inkurajon mjekët të raportojnë aktet e dhunës ndaj mjekëve dhe profesionistëve shëndetësor, ku gjithashtu duhet aplikuar një politikë zero tolerance ndaj dhunës në vendin e punës.

Komiteti i Përhershëm Evropian i Mjekëve (CPME) është institucioni ndërkombëtar me ndikimin në politikbërje në nivel evropian dhe ka një rëndësi të madhe në rregullimin e sektorit shëndetësor në nivel te vendeve të Bashkimit Evropian, ku pas të gjitha takimeve të mbajtura konkluzat e takimit i dërgohen Komisionit Evropian për reformimin dhe rregullimin e politikave shëndetësore

Oda e Mjekëve të Kosovës është anëtare vëzhguese në këtë organizatë që nga viti 2018, ku deri më tani ka marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara.

## 12.5 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën <b>janar-mars</b>	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën <b>janar-mars</b>	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën <b>janar-mars</b>	Vendime për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
<b>Kryetari i Odës</b>	5	5	6	2	0

### **13 Plani i veprimit për 2023**

#### **Projektet/Planet 2023**

- Fillimi i zbatimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH-të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë” dhe OPSH-të.
- Fillimi i zbatimit të sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 2.5 vite.
- Organizimi i Kongresit të V multidisiplinar
- Organizimi i ceremonisë së 10 vjetorit të formimit të OMK-së
- Fillimi i zbatimit të projekteve për profilizim dhe shkollim specialistik jashtë vendit
- Vazhdimi i zbatimit të Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim KSV/017 - 21 2749, faza e dytë për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve
- Hulumtim për vlerësimin e ngarkesës së sëmundjes kronike dhe sindrominit burnout (shpenzimi profesional i mjekëve)